

VENDIM
Nr.779, datë 15.7.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS QESARAT, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Qesarat të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Qesarat të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.417, datë 9.6.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të komunës Qesarat të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Qesarat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Qesarat

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-14	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
15	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
16-22	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
23-36	Varrezat publike	Në pronësi
37-71	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
126-128,130,131,133- 136,138,141,143,145,147-150,152-154	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
129,132,137,142,146,151,155,158, 163,166,167,168,169 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
172-224,226,229-353	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi